Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/01-18613/2026
Kaçanik, 30.07.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 30.07.2026 (e enjte), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendi i Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 19 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari Betim Shala. Konstatohet se pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 20 anëtarë. Mungoj me arsye 1 anëtarë: Hafize SallahuNga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, 09 drejtor të drejtorive. Nga zyrtarët: Zyrtari i IT. Asistentja e Kryesuesit të KK dhe këshilltarja e kryetarit.
Mbledhja ka qenë në transmetim të drejtpërdrejtë.
Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Arianita Bajrami – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit .

Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni: Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin. duke i thirrur me emër, një anëtar, Hafize Sallahu mungon me arsye. Kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka. e hapi mbledhjen e VII-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 30.07.2026, me këtë:

z. Selajdin Troni:, vazhdojmë me rendin e ditës:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit Komunal;
2. Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt:
3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026:
4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;
5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025:

6. Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK. Elezaj;

7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;

8. Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës;

9. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës.

10. Kërkesë nga MAPL për shqyrtimin e vendimit 01Nr.104/02-11476/26 për aprovimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kacanikut.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin.

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

z. Selajdin Troni: A ka dikush dicka rreth procesverbalit?

Heset Malsiu: Procesverbali është shumë i mangët tek pjesa ime, nëse ka mundësi ta dërgoj për përmirësim pjesën.

Jeton Luma: Njejtë edhe unë.

Selajdin Troni: në rregull d.m.th me plotësim ndryshime e hudhim në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja VI (gjashtë) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 29.06.2026

Pyetje dhe Kërkesa

Jeton Luma: Sot dua te ndalem ne fushen e Kultures, dhe dua te them se komuna ka investuar fare pak në këte fushë për të mos thënë fare. Shumë monumente janë lënë pas dore dhe po dëmtohën edo ditë e më shumë, si shkak i mungesës së invështimëve dhe mos mirëmbajtjes. Shtëpia e Kulturës në fshatin Gllloboqicë. kërkoj që të bëhet renovimi i plotë i objektit. Të krijohet një qendër rinore dhe një zyrë për administratorin e fshatit. Kemi mungesë të hapsirës për të rinjët në fshat.
Meqenëse shkolla e fshatit mbanë emrin e heroit "Avdylgafurr Luma" kërkoj që shtëpisë së Kulturës ti vendoset emri i heroit tjetër "Osman Luma".

Ardita Rrahmani: Kam disa kërkesa, banorët e fshatrave Ivajë e Shtrazë janë tejet të shqetësuar per rrugën dhe kërkojnë të dinë kur do të intervenohet për rregullimin e saj. Banorët e Lagjes Caka (konkretisht Muhamet Zeneli) kërkojnë vendosjen e një pasqyre konvekse tek dalja e lagjes apo konkretisht në kyqjen e magjistrales.

Islam Gashi: Ankesë mbi ndarjen e parcelës për vorrezat e fshatit, shumë lagje janë detyruar të ndajnë parcela private, varrezat ekzistuese janë të mbushura dhe lutem që kjo punë të merret seriozisht.

Sabedin Vishi: Vendimi për ndarjen e parcelës për vorreza në fshatin Begracë është që nga 2016, mirëpo ka ankesa nga qytetarët e tjerë që nuk janë marrë nënshkrimet nga të gjithë d.m.th. nga mosmarrëshjet e banorëve.

Kjani Zeneli: Kam tri kërkesa, i kam dhe me video.
Në lagjen Dushkaja, tek shtëpia e mësuesit Behlul Shehu, shiheni se si i futen ujrat atmosferik ne oborr.
Në fshatin Gjurgjudell tek Avdi Bela, investitor nga diaspora, vërshimet e fundit i janë futë në fermë.
Zona turistike Sharr në fshatin Shtrazë nuk ka drita në mbrëmje, lutem qe të merren masa.

Kadrije Lika Troni: Kam një shqetësim për drejtorinë e Kulturës, Kalaja e Kacanikut ska mirëmbajtje dhe është në gjendje alarmante, ka gurë të rënë nga muri i Kalasë, gjelbërimi i pakontrolluar dhe pamirëmbajtur po rrezikon strukturën e monumentit, Kalaja është identiteti ynë kështu që kërkoj që më urgjencë që të intervenohet në këtë pjesë.

Buletin Guri: Punimet ne cerdhen e fshatit Nikaj janë në përfundim kam një pyetje se a ka Komuna ndonjë plan të instaloj sinjalizim horizontal dhe vertikal në rrugën tek cerdhja. Dhe cfarë hapa po merrni ju për finalizimin e këtij projekti.

Jeton Luma: Herën e kaluar bëra një pyetje për zyren e vendit në Gjloboqicë, më thatë që po funksionon, nuk është funksionale sic di unë, më thatë që do marr përgjigje me shkrim por nuk kam marrë.

Ardita Rrahmani: Po më interesON me dit se impianti i ujrave të zeza në Ferizaj, me njohuritë e mija, zgjidhja tash e dy vite qëndron në sirtaret e MF, ku nuk nënshkruhet nga ministri, dua të di se cka po ndodhë, a duhet të bëhet trysni edhe më e madhe si komunë.

Sabedin Vishi: E kemi pa ne rrjete sociale edhe ne, kemi pas takime edhe me shefin e Bifurkacionit për këtë cështje, ato që janë kërku nga në janë të gjitha në rregull, barrën financiare e ka komuna e Ferizajit, ata kanë nda mjete por sic dimë është në procedurë por vazhdojmë me pritë.

Kadrije Lika Troni: Më herët e kishim votu një pjesë të parcelës për ndërtimin e impianit në Kacanik të Vjetër. A jeni në në kontakt me kryetarin e Ferizajit lidhur me kete cështje.

Sabedin Vishi: Është nënshkruar marrveshje mes nesh, këtë obligim e ka detyrim Ferizaji e fizibilitegin e projektim është dukee e udhëhequr Bifurkacioni, prap do shkoj edhe njëherë ekstra për këtë punë.

2. Propozim –Vendimin për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

E hapi diskutimin drejtor:

Arian Teneqja: Plani Ndërkomunal për menaxhimin e Mbeturinave është bërë për rajonin e 5, është plan voluminoz që na është kërkuar të votohet në Kuvend, për të mirën e këtyre qyteteve.

Jeton Luma: Mesa e pashë parashihet që në vitin 2027 pagesa do rritet për dy euro, a mund të na tregosh sa qëndron kjo.

Arian Teneqja: Jo kjo nuk qëndron, kjo ka pasë nevojë të vendoset për planifikim dhe nuk do të thotë që do të jetë ashtu.

Kadrije Lika Troni: Uroj që të zbatohet në praktikë, unë dua të di se kush mban përgjegjësi për monitorimin e këtij në nivel komunal, a mban përgjegjësi DShPE, Pastërtia apo Komuna e Kacanikut.

Arjan Teneqja: Është plan ndërrajonal, duke përfshirë disa komuna, plan me kosto shume te lartë financiare 2026/30, kjo duhet të ketë përkrahje nga niveli qëndror. DShPE është përgjegjëse për implementimin e tij.

Kadrije Lika Troni: Ku është mëndu të bëhet oborri i riciklimit ne Kacanik, a është mendu në këtë plan.

Arjan Teneqja: Kjo është mendu të jetë e përbashkët, nuk ka të paraparë për në komunën tonë përvec oborr transferi apo grumbullimi.
Në bazë të viteve të kaluara janë menduar me përpikëmëri këto.

Xhelal Ceka: Desha të ndërlidhem se këtu është parapa si ndarje e mbeturinave dhe të gjindet një vend regjional për Riciklim, kemi në Gërlicë një deponi që nuk përdoret më, por në Mirash.

Kadrije Lika Troni: Ka biznese në komunën e Kavanikut qe nuk kanë as kosh mbeturinash por paguajnë si të gjithë, por edhe veprimaritë që i ushtrojnë janë pa mbeturina, të bëhet një zgjidhje pak më e volitshme për të gjithë.

Xhelal Ceka: Jo vetëm që du me ja lënë nivelit qëndror fajin por e kemi fitu një grant prej 110 mijë eursh nga performanca e mirë, që ministria është dashtë ti ekzekutoj ku është parapa që ti shpenzojmë për një kamion dhe për kontinjera por nuk kanë ecë procedurat, por ministria nuk i ka pa të arsyeshme. Kemi pasë përfaqësues nga VV dhe nga PDK por nuk kanë ndihmuar aspakt, vetëm pagën mujore e kanë marrë.

Kadrije Lika Troni: Nuk desha te dal në nivel qëndror, bizneset paguajnë Pastërtinë por nuk kanë kontirjera.

Xhelal Ceka: Kur të doni dalim dhe pyesim qytetarët, u kam ofruar për dy muaj ditë shërbime pa pagesa vetëm që klienti ta marrë kontinjerin e vetë por nuk kanë shpreh dëshirë, ky vendim sështë leju këtë e kam bë unë vetë si menaxher. Te ne vec një javë mos më i marrë mbeturinat shihet rezultati, më vjen keq qe sillen edo ditë tek zyra dhe kanë kërkesa për kontinjera por ne nuk kemi financa.

Ernesta Krasniqi: Xhelali pe shpreh gatishmërinë për përgjigje po i drejtohem, përveç komisionit që po thuhet se ska ndihmu askush, ky komision paguhet nga Pastërtia me sa di unë, ju si menaxher pse nuk keni kërku apo bë një ankesë se këta anëtarë nuk po kryejnë punën sic duhet dhe si kishi pagu, the se kanë marrë pare dhe skanë ndihmu, pse me pagu anëtarë që nuk kryejnë funksion.

Xhelal Ceka: Unë si ish menaxher, unë menaxhimin e kam kry vetë nuk kam pas nëvojë për ndihmë por thash se nuk e dinë se cfarë pune bëjmë anëtarët nga ky kuvend.

Sabedin Vishi: Tek cështja e kontinjerave, ne nuk kemi ndonjë ankesë me shkrim, e di që ka probleme dhe arsya e tyre është që mjete financiare aktualisht nuk kanë, një prej shpenzimeve është ndalimi i deponisë në Gërilicë, dhe i dërgojnë në Gjilan. 100% objektivat nuk mundet me i arrit asnjë organizatë. Ne po kontribuojmë në këto probleme që mund ti kenë KRM Pastërtia. Ndër komuna jemi më së miri në këtë drejtim, tek bizneset nëse ka ankesa është mirë me na tregu.

Kadrije Lika Troni: A shkon kontinjeri dërgesa varësisht nga lokali i vogël, nga veprimtaria, apo është obligim ta ketë, edhe ky propozim për marrëveshje me biznese dhe Pastërtinë, me ndihmu edhe biznesin por edhe si pagues i rregullt të mos ndëshkohet.

Arjan Teneqja: Ne si DShPE, momentin që qytetarët kanë ankesa ata janë të lirë të vijnë dhe të drejtojnë tek ne, ju kisha lut të kthehemi në temë.

Jeton Luma: sa i përket ankesave si koncept bazë është e drejta e shprehjes dhe secili e kemi këtë të drejtë.

Selajdin Troni: Jua kemi dhënë këtë mundësi sa keni deshtë. A ka dikush rreth kësaj pike me shtu dicka, nëse nuk ka athërë e hedhim për aprovim. 20 për, Prezent ishin 20, me këtë rast Kuvendi konstatoj se mori:

VENDIM
për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave Për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

3. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026;

Valdrin Dogani: Prej një projekti kapital mjetet janë bart më një projekt tjeter brenda planit buxhetor, bëhet fjalë për lëvizjen e mjeteve nga asfaltimi i rrugës Hamzë Jashari Silgapor-Rakaj. Ne atë Qemajl Guri, arsyeja është se në projektin paraprak kemi pasë të buxhetuar 70mijë Euro, 50 mijë euro nga qeveria nuk kanë bë të pamundur investimin kapital, pjesën tjetër e kemi rialoku në mënyrë që rruga të plotësohet me trotuarë dhe ndricim. Përmes këtij sqarimi kërkoj që të votohet ky rialokim.

Bashkim Krasniqi: Sa i përket alokimit të mjeteve projekti "Hamzë Jashari" ka qenë i rëndësishëm por me qenë se kontrata kolektive ka me na vonu shumë projekte po më vjen mirë

qe po rialokohen mjetet te rruga Qemail Guri, ne jemi pro kti rialokimi.

Kadrije Lika Troni: Pse projekti Hamzë Jashari nuk ka nisur fare, kur ka qenë i planifikuar dhe a janë njoftuar banorët e atij segmenti qe nuk do të rregullohet rruga e tyre, cilat janë kriteret që keni vendosë se cila rrugë është më prioritare.

Bashkim Krasniqi: aty nuk ka banorë fare.

Valdrin Dogani: Në atë segment nuk ka banorë, ne nuk kemi mujt me nis projektin sepse janë terhjek mjetet nga departamenti i thesarit. Përndryshe ne veq e kemi përfshi në fillimin e procesit buxhetor 250 mijë total euro për tri vite.

Kadrije Lika Troni: Nëse bëjmë rialokimin a do largohet fare si projekt ky?

Islam Gashi: Projekti thekson se marrja e 20 mijë euro nuk e rrezikon fare projektin sepse nuk ka nisur fare si procedurë nga prokurorimi, a po e pranoni këtë që ky projekt ska pasë me u realizu në këtë vit edhe nëse nuk kishin me a marrë këto vendime.

Valdrin Dogani: Mjetet buxhetore që po rialokohen janë mjete të paangazhuara, ne po i vendosim diku që ta bëjmë punën sic duhet Kam një pyetje për ty Islam a e din datën kur është votu ligji i buxhetit, pa i pas fondet në dispozicion nuk mundesh me iniciu, sapo janë alokuar mjetet janë tërhjekur.

Ernesta Krasniqi: A ka projekt për rrugën Qemajl Guri dhe a ka një vlerë për këtë rrugë?

Valdrin Dogani: për projekt po ja jap fjalen drejtorit DShPE.

Buletin Guri: Rruga Qemail Guri është projekt i premtuar disa herë rradhazi, projekti ka qenë që rruga të mos bëhet e pjerrët, a do ketë sigurtë trotuarë dhe ndricim publik, nëse po unë jam për.

Arjan Teneqja: Kur e kemi pa mungesën e mjeteve dhe po dështon si projekt për këtë vit, ne kemi ripërpunuar projektin për rrugën Qemajl Guri, dhe pjerrtësia dhe rregullat janë në bazë të komunikacionit.

Ernesta Krasniqi: Planifikimi dmth ka qenë gabim herën e parë, a është 36 mijë euro Planifikimi Buxhetor, investimet kapitale njëri projekt me 0% realizim është 36 mijë euro, dmth planifikimi Buxhetor ska qenë i saktë, dmth sju kanë dal ato, tash pju duhen edhe 20 mijë tjera.

Valdrin Dogani: Në ligjin e buxhetit ndarja është bërë në dy vite, pas dështimit të projektit paraprak që ta kryejmë më shpejtë po i rialokojmë.

Sabedin Vishi: Zakonisht kur planifikohen OBK, asnjëherë nuk e qesim në asnjë projekt komplet grant, arsyeja se nëse i ndajmë 100 mijë euro, hyn dikush me 80 mijë euro atëherë ne e rrezikojmë grantin duke e mbështetë dhe me HV-këtë, hala pa fillu procedura thesari ka marre pjesë të mjeteve dhe pas marrjes së atyne mjeteve i kemi kompletu nje projekt tjeter që të kryhet për një vit, sa i përket premtimit ai është bërë në tetor dhe po realizohet sivjet.

Jeton Luma: Ka qenë e paraparë me 36 mijë Euro dhe 40 mijë euro ti shtohen sa është tërsia e shumës qe do ta mbuloj, a i bie 56 mijë euro?

Valdrin Dogani: Unë po kërkoj mbështetje, qëllimi është të bëhet rruga e kompletuar, përndryshe për projekt din drejtori më shumë.

Arjan Teneqja: thash më herët se do të vazhdohet rruga 6m dhe trotuari 1.5m

Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka e hedhim pikën në votim. 15 për/ kunder/ 5 abstenim. Prezent ishin 20, me këtë rast Kuvendi konstatoj se mori:

VENDIM
Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2026

4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën 01.01.2026 - 30.06.2026;

Islam Gashi: Dobsitë më të mëdha të këtij raporti janë investimet kapitale, janë realizu vetëm 29.83, duke shpenzuar vetëm 956 mijë 678 euro nga 52.6 nuk janë investime kapitale por pagesa për vendime gjyqësore, investimet reale kapitale janë vetëm 14.1% e buxhetit total. Shifër alarmante!
Kemi një rënje nga viti i kaluar-17.6% me 29.3%. Tatimi në pronë është inkasuar vetëm 21.39% e planit, kjo nuk është hera e parë që ndodh, e njejta gjë ka ndodhur edhe vitin e kaluar. Në tabelën 11 te projekteve kapitale shohim shumë projekte jetike që kanë 0% realizim. Rasti i bujqësisë shohim se subvencionet dhe investimet kapitale shohim që ska shpenzime edhe ato shërbime kulturore skanë shpenzuar asgjë.
Buxheti aktual në tabelën 1 është shënuar se është 13 milionë 405 mijë e 993 euro ndërsa në tabelën 4 është 13 milionë 399 mijë e 753 euro, njejtë me buxhetin filledtar.
Në tabelën 11 kodi projekti kapital, në fshatin Begracë, projekt 30 mijë eurosh është shtuar edhe një fshat dhe tani kemi edhe një kontratë në vlerë 22 mijë euro. Nëse kuvendi i kish nda këto mjetë vetëm për fshatin Begracë me cfarë të drejte është përfshirë dhe fshati tjetër, pse është premtuar shtrimi rrugëve e në kontratë shënon vetëm shtruarje me zhavor.

Valdrin Dogani: Të gjithë e dijmë që ligji i buxhetit na ka vonu, na ka vonu me i iniciu procedurat, ato kërkojnë afate e kohë, në momentin që ipet kontrata fillon realizimi. Gjatë raportit ndryshon kjo vlerë, përmes prokurorimit ne njoftohemi nga realizimi u projekteve, sa i përket inkasimit tek Tatimi në Pronë, e kemi kontaktu posten e Kosoves për shpërndarjen e postave në komunë,e cila na kanë njoftu që me datën 30 Qërshor ka pranu faturat, ketu tregon pse ka ra inkasimi. Kemi me reflektu tek rritja e inkasimit në 3 mujoreshin e tretë. Tek tabela 11, buxheti aktual është paraqit 2 herë sepse kemi prit se ka me u realizu edhe bartja e mjeteve vetanake paraprake. Veq është lënë e gatëshme me përfshi edhe këtë, më datën 13 korrik kemi pranu që është realizu.

Selajdin Troni: shkak i pagujdesisë nga lart ne po pësojmë.

Islam Gashi: Pse në tabelën numër 10 kemi tan ato projekte me 0% realizim. Sa ka gjasa që këto projekte që të mos realizohen?

Valdrin Dogani: Ligji i Buxhetit është bërë me vonesë, zyra e prokurorimit kërkon zotimin e mjeteve për inicim të projekteve.

Sabedin Vishi: tek cështja e rrugëve kemi fillu për herë të parë dhe e kemi marrë në fshatin ku punohet më së shumti toka në Begracë. Para se me nis procedurën, drejtori ka dalë në terren tek lagja Luzha, nuk kan ra në ujdi për zgjerimin e rrugëve andaj për mos me rreziku është lënë edhe në Biqec-Nikaj.

Islam Gashi: A ish dasht që me ardh ky rialokim në kuvend gjithësesi? Ky është projekt 3 vjecar, a ka me qenë vec për Begracë.

Sabedin Vishi: Ky planifikim ka qenë vec për Begracë, por viteve tjera vlen edhe per fshatrat tjera ku ka prioritet më shume dhe arsyeshmëri.

Islam Gashi: A ka drejtë ligjore kryetari apo drejtori me i transferu mjetet diku tjeter pa ardhë në kuvend me këto arsyetime.

Sabedin Vishi. Në moment që ec procedura, ka pasë pengesa por pjesa dërrmuese shkon prap në Begracë.

Jeton Luma: Pasi e shqyrtojmë këtë raportin du me u ndal edhe unë tek disa pika, pjesa ku duhet të vendoset theksi është tek investimet kapitali, kur merr shumën totale 3.2 milion euro është realizu vetem 29.83% nivel koxha i ulet i pjesës së parë të vitit, nëse e hjek edhe pjesën ku paguhen vendime gjyqësore realisht i bje vetëm 14% mirëpo përsëri për gjysmën e parë të vitit është tëpër pak, a kemi garancë që deri në fund të vitit do vazhdojënë projektet.
Ka projekte të rëndësishme që nuk kanë fillu aspak.
Kjo vonesë tregon mospunën e administratës komunale. 300,000 euro janë të planifikuara pëe fushën e kulturës asnjë cent sështë realizu.

Heset Malsiu: Unë në këtë raport pashë inkasimin tek lejet ndërtimore që është më shumë se dyfishi se viti i kaluar që është zhvillim në Kacanik. Realizimi në vetëm 14% në investime kapitale uroj të mos jetë dita e mirë shihet në mëngjes, metëvërtet ky realizim na shqetëson të gjithëve, nuk e di si do tja dalim deri në fundvit.

Sabedin Vishi: Investimet Kapitale është e vërtetë që janë me shumë të ulët por këtu është i përfshirë vetëm gjashtë mujori i parë, për herë të parë kemi pas mjetet e ndara për të nisë procedurat e prokurimit. Të gjithë besoj që jeni në dijeni se buxheti është vonuar, asnjë investim kapital ska mbet pa inicuar, ajo cka ne po penalizohemi është nëse kemi ankesa mes operatorëve, përndryshe gjashtë mujori i parë gjithmonë ka qenë më i vështirë por sërish gjithmonë ia kemi dal të jemi 99.99% në shfrytëzim të grantit qeveritar. Rruga Runjevë-Stagovë ka qenë përfitim i grantit qeveritar nga performanca por e kemi humb shkak i operatorëve, vonesave nga ankesat. Nëse një projekt nuk është nis fare atëherë do të thotë që na ka ndalë kontrata kolektive. Për herë të parë e kemi nda për mirëmbajtjen verore dhe dimërore, trotuaret, kemi me nis me i mbush edhe disa gropa, rrugët urbane, kalldërmi, e të tjera.

Ardita Rrahmani- Projekti Runjevë- Stagovë, a ekziston një mundësi që si shkak i humbjes së këtij granti nga operatorët, ne si komunë a mundemi me ndërrmarë dicka apo ju si pjesë e asociacionit të komunave a është ndërmarrë dicka.

Sabedin Vishi: Shqetëzimet e njëpasnjëshme i percjellin sidomos kontrata kolektive ka qenë ajo e cila i ka dëmtu më së shumti gjitha komunat, por ne pakëz më mirë është që ne kemi mund me e bë një marrveshje me mësimdhënësit, e sa i perket rrugës kemi diskutu me ata të rezultatit të performances duhet të shpenzohet brenda atij viti.

Islam Gashi: Tek investimet kapitale ndryshimi nga 48% është bë 29% këtë vit, pasi që tre

mujorëshin e parë thatë nuk është kryer asnjë projekt. tek raporti financiar shkruan qe kanë qenë investi 451 mijë euro për investime kapitale veca tjeravr i bie qe 137 mijë janë shpenzuar për projekte që i bie se ka pasë projekte

Sabedin Vishi: Realisht ka pasë kontrata dy vjecare të cilat kemi pasë drejt me i vazhdu këtë vit.

Islam Gashi: Edhe te bujqësia e di që për bleta janë nda subvencione, edhe pse është e shënuar 0, te kultura 0 edhe pse janë nda rreth 300.000 euro.

Valdrin Dogani: E vërtetë që janë nda subvencione për bletarët por pagesa qshtë ekzekutuar në korrik, prandaj sështë përfshi, kemi dy projekte kapitale në pjesën e kulturës, janë të iniciuara procedurat. Ka me ndryshu gjendja në raportin nëntëmujor financiar andaj ka me qenë një shifër akoma ma e mirë.

Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka vazhdojmë me pikën tjetër pasi që kjo kalon vetës si informatë:

5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025;

Ernesta Krasniqi: Plani i veprimit, në parim ne jemi pro planit, ma e rëndësishmja është që ky plan të zbatohet por përderisa raporti i auditimit vjen me rekomandime të përsëritura ne nuk mundemi me vazhdu me votu plane të cilat mbesin veq plane e nuk zbatohen mos të harrojmë që pas raportit të vitit të kaluar kemi pas një plan veprimi por sa është zbatuar e kemi parë kur ka ardhë ky raporti i fundit ku ka edhe më shumë rekomandime. Ne nuk vazhdojmë ti votojmë planet.

Selajdin Troni: Nëse nuk ka dikush dicka vazhdojmë me pikën tjetër pasi që kjo kalon vetës si informatë:

6. Propozim-Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;

Korab Krasniqi: Këtu kemi të bëjmë me një propozim për inicim për shpallje të parcelave me interes publik në ZK Elezaj, te cilat janë në pronësi private, kjo po bëhet me mundësi për zgjerimin e rrugës dhe krijimit të një rruge të re. Unë e kam përgatit edhe në formë digjitale, te cilën e shohim këtu, në rrugën aktuale ka të ndërtuara dy shtëpi kështu që nuk shfrytëzohet për cka është, prandaj këto shtëpi kanë vendos ta bëjnë një marrveshje që ta zhvendosin rrugën në pjesën e poshtme, pjesa me ngjyrë të kuqe, besoj që është e qartë si propozim dhe konsideroj që duhet të ecë si proces pasi që kështu aktualisht nuk përdoret si rrugë dhe të krijohet një zgjidhje më të mirë.
Normalisht e kemi si kriter që të marrim më shumë hapsirë se sa që ipet, që të krijohet një hapsirë më e madhe

Buletin Guri: Shpesh na vinë pika të ngjashme. si gabime të institucioneve, si ka mundësi që shtëpitë të mdërtohen nëpër rrugë, kjo i bie që zyrtarët komunal po korruptohen dhe është për keqardhje që nuk dalin inspektorët komunal, fatkeqësisht nuk ka pas asnjë distancim nga pjesëtarët e ekzekutivit pikërisht për rastin e tillë para dy javësh.

Korab Krasniqi: Këto shtëpi janë ndërtuar para lufte, kështu qe nuk e di sa kemi mundësi të marrim përgjegjësi për atë pjesë.

Kadrije Lika Troni- Desha të kërkoj se a është qekjo parcelë që ka ardhë si pikë e rendit të ditës por e keni tërhjek.

Korab Krasniqi: Unë kam konsideru se ka nevojë akoma për përmirësime

Kadrije Lika Troni: Unë personalisht këtu nuk shoh që ka ndonjë interes publik, ky është interes personal i banorëve të cilën kanë mund me e rregullu vetë, e me këmby ne toka këtu, ne ktu jemi për me dhënë këshilla, pse ne me dhënë pronë të komunës.

Selajdin Troni: pasi që janë koordinu kta banorët neve sna kushton asgjë për me e ec përpara

Korab Krasniqi: Unë mendoj që interesi i qytetarëve është edhe interes publik i komunës, kjo rrugë është e papërdorëshme, kta janë duke dhënë tokë të vetën, e cila bëhet pronë publike, unë nuk kam vullnet me i prish shtëpitë.

Kadrije Lika Troni: Në bazë të matrialit unë kam pa se komuna ka deshtë me dhënë 1000 metra më shumë që ta këmbej rrugën, andaj e ke tërhjek.
A mundesh me na tregu sa po marrim e sa po japim ne si komunë?

Korab Krasniqi: Kemi marr 1683 metra katrorë kemi me i dhanë 1336 metra katrorë. Këtu është e shënuar.

Ernesta Krasniqi: Sa e kuptova prona te cilat banorët kanë ndërtu këto shtëpi nmes rrugës, a krejt janë kry para lufte a?
Kjo rruga që ju po e bëni rrugë publike, kujt po i shërben?

Korab Krasniqi: Kjo rrugë u shërben qytetarëve që banojnë aty. E për me e pa kur është bë ky ndërtim vetëm me ortofoto ne gjeoportal secili mundeni me pa.

Heset Malsiu: Unë mendoj që hapja e rrugës është interes e qytetarëve, por në këtë rast rrugët duhet të hapen edhe në prona private, sexili mundet me e bë në prona të veta. Tjetra, a do të vazhdoj ky sistem kështu.

Korab Krasniqi: Po ju premtoj qe kemi me vazhdu sepse nuk kemi asgjë me fsheh, përndryshe nëse kta kanë vullnet me qel vetë rrugën ne skish pas nevojë me ndërhy fare.

Bashkim Krasniqi: Kjo rrugë është e lëshuar nga vetë banorët e cila nuk po përdoret më, unë mendoj që interesi publik në këtë rast janë vet banorët.

Xhelal Dema: Desha me bë një sqarim, ata kanë apliku për legalizim e përderisa është në pronë komunale shtëpia besoj se ata kan mund edhe vet me bë zgjidhje po shkak i kësaj është desht kshtu.

Ernesta Krasniqi: As rruga aktuale sështë e shtruar, as ajo që do hapet. Neve po na intereson me ditë.

Kjani Zeneli: Unë nuk jam i kënaqur aspak me këto ndërrime, unë këtë nuk e votoj kurrë pa e kuptu mirë.

Selajdin Troni: Ti e ke qu dorën për pjesën tënde atje, ktu është pjesë me ju dhënë qasjë qytetarëve.

Korab Krasniqi: Kjo hapje e rruges i jep qasje edhe 8 pronave të reja. Kemi një mundesi që me ju bë zgjidhje qytetarëve, dhe me ofru mundësi.

Kadrije Lika Troni: Dmth kjo parcela 1490 ka me u këmby dhe nuk po kompenzohet me rrugën, pse spo na tregon për këtë parcelën që ka me ju dhënë edhe ajo?

Korab Krasniqi: Ndoshta më ka ik kty detaj, kjo parcela 164-2, 149-0 janë pronë komunale dhe ndërrohen me këtë tjetrën.

Kadrije Lika Troni: Ska more nevojë komuna me dhënë prona, pse unë nuk i thashë komunës me më ndërru prona për me hap rrugën. Ju mundeni me i dakordu banorët po ska nëvojë për ndërrim prone. Edhe në MAPI kam me dërgu këtë.

Ardita Rrahmani: E kam një pyetje për këta që po e refuzojnë, këtu janë 3 ari, cka mundet me ba komuna me qeto 3 ari? Me 3 ari fushë sportive a? Unë jam për me ju bë zgjidhje qytetarëve.

Brahim Imishti: Unë vec deshta me ju pyet LVV, para kësaj seance e kemi votu një pikë gati të njejtë por për një biznes, aty keni mund me i ra nëpër depo por e keni votu unanimisht.

Selajdin Troni: Atëherë nëse nuk ka edhe dicka e hudhim këtë pikë në votim. 11 për, 2 abstenime, 7 kundër. Prezent 20. Me këtë rast konstatoj se Kuvendi Komunal mori:

VENDIM
Vendim për shpalljen në interes publik të parcelave kadastrale në ZK, Elezaj;

7. Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër;

Arlinda Rakoci - Ndryshimi vlen vetëm për ndryshimin e numrave të lokaleve në kadastër sepse pas regjistrimit ka ndryshu numrat, vetëm cështje teknike. Nga ky vendim fillon jepja në shfrytëzim të pronave për krijimin e kushteve për bizneset, do jepen gjithsej 18 lokale.

Kadrije Lika Troni - Ndërtimi i këtij objekti ka gilluar në vitin 2016, a ka leje ky ndërtim, cfarë shume është shpenzu për ndërtimin e këtyre lokaleve.

Korab Krasniqi: Punimet kanë fillu 2021, ka leje ndërtimi dhe është në rregull me dokumentacione.

Valdrin Dogani: Në vitin 2022 është nënshkruar vendimi për ndërtim, vlera për këtë projekt ka arrit 320.937 euro.

Kadrije Lika Troni: Ky lokacion përfshin hapsirën nga busti i Idriz Seferit deri tek cajtorja e agës bub. Sipas Planeve Urbane Komunale, PZhU deri 2010-2020 dhe PRrU për zonën e parë dhe të dytë i vlefshëm 2012-2017, mundësi e shfrytëzimit të tij deri në një dokumentacion tjetër, ky lokacion ka qenë i paraparë për hapsirë publike si brez i gjelbër, ndërtimi i ketij objekti është në kundërshtim me planin urban, ky lokacion është pjesë e planit rregullues urban edhe pasi në këtë plan është caktuar tjetër destim, ky ndërtim është kundëligjor, ne gjithmonë jemi për të u ndihmuar qytetarëve por jo duke vepruar kundërligjshëm, ne sot do ta votojmë këtë por pjesa tjetër e juaja e ndërtimit le të mbetet në përgjegjësinë tuaj.

Korab Krasniqi: Ajo që po e përmendni ju ka qenë e destinuar të jetë shteg por ka pasë nevojë të prishen shumë objekte të tjera por ato objekte unë mëndoj që ja kanë shtu edhe një pjesë edhe hjeshinë dhe të këtë një pjesë të vjetër qyteti jonë dhe të jetë si zgjidhje më e mirë. PZhK nuk është në fuksionim që nga viti 2017. Unë këtu nuk shoh shkelje të ligjit.

Betim Shala: Dua ta sqaroj se nuk e kam lëshu unë këtë leje. Nëse nuk ka plane rregulluese per zonën e parë dhe një pjesë të zonës së dytë sipas. Thuhet se ky plan ka vlefshmeri 5 vite, nuk mundemi me quajt një plan të vlefshëm kur e humb vlefshmërinë e vetes. Po nëse nuk ka plan rregullues atëher vazhdohet me ato.

Kadrije Lika Troni: Nëse ka 5 vite afat, pas sa kohe duhet të shfrytëzohet ai plan.

Betim Shala: PZhK dhe PZhU vazhdojnë edhe pas skadimi por Planet Rregulluese nuk janë të obligueshme. Plani i zhvillim urban në fakt mu nuk është me ligjin e ri për planifikim opsional. Plani i zhvillimor urban vazhdon edhe pas skadimit vazhdon automatikisht. Po planet rregulluese më me ligjin e ri për planifikim hapsimor nuk janë të obligueshme.Janë veç në për zona të cilat komuna e e she të arsyeshme që duhet me u bë plane rregulluese që tash janë të obligueshme plani zhvillimor komunal edhe harta zonale ama nuk është e harta zonale nuk mundet me u bë po u bë plani zhvillimor komunal e plani rregullues. Ti mundesh me bë plan rregullues për një zonë turistike, për një zonë të veçantë të qytetit ose një zonë diku qe sheh.

Kadrije Lika Troni: Qe tash po ta bëj një pyetje ty meqë i përmende hartat zonale se pikërisht unë e kam parë një dokument të nënshkruar prej teje që operatori e kishte nënshkruar për harta zonale edhe pagesa është bërë ndërkohë s'ka harta zonale. A mundesh me na tregu qëta qysh paguhet operator kur s'kena harta zonale?

Betim Shala: Unë nuk i bëj hartat zonale. Duhesh me ditë me kuptuar procesin e kontraktimit po dikuj që ka me bë një projekt se edhe harta zonale, plani rregullues, plani zhvillimor komunal. Po ta shpjegoj kështu prej fillimit edhe ta shpjegoj që tash e kam nënshkruar unë edhe ta shpjegoj pse s'u miratuar. Po edhe pse mu plani zhvillimor komunal i 2010-ës, plani rregullues i 2012-s edhe që harta zonale janë të kontraktuar me palë të jashtme, domethënë me kompani të jashtme, në vitin 2017 kur se ndoshta s'i ke kqyr letrat hiç a krejt se kur t'i kqyrh letrat duhesh me i kqyr letrat krejt jo veç gjysëm në vitin 2017 kur u bë miratimi i kuvendit të komunës për me vazhdu me harta zonale unë nuk jam kanë në punë hiç. Unë jam kthyer në punë meë 2 maj 2017n. Kjo u morrë vendimi më herët. Komuna e ka kontraktu një ekip për me bë hartat zonale e ka kontraktuar një ekipë të jashtme, domethënë një kompani të jashtme të licensuar. E kompania. Unë kam qenw mbikëqyrës i asaj kontratës ndoshta e ke parë aty që janë që tre at ku e ke parë nënshkrimin kryesues i komisionit ë s'ka kryesues të komisionit janë tu me as të barabarta apo në rregull

edhe nëse domethënë kryesues në rregull kompania e ka kryer punën e vetë janë procedurat e urbanizmit mbasandej edhe arsye që sipas meje të arsyeshme pse s'ka vazhduar se s'ka mundur me vazhdu me përpara para me zbatu atë plan me çu në kuvend edhe për me pa atw cka e kam nwnshkru mundet secili.

Islam Gashi: A është bërë ndonjë analizë nga komuna se cili është përfitimi financiar nga dhënia janë shfrytëzim i këtyre 18 lokaleve? përafërsisht a u caktuar sa ka me qenë metër katror i qirasë dhe diçka a kanë këto objekte pranim teknik

Arlinda Rakoci Raka: Analizë nuk u bë po normal këto është për biznese kanë me përfituar bizneset por njëkohësisht edhe kanë me bërë pagesën ndaj komunës e qirasë me rregullore është rregullorja për taksa dhe tarifa

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 19 vota pwr asnjw kundwr dhe asnjw abstenim konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM
Propozim-Vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtëshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër

8.Propozim-Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës;

Selajdin Troni: Tash e kemi formimin e komisionit te pika e tetë ë. Dy anëtarë shku nga ekzekutivi, një anëtar nga PDK, një nga Vetëvendosja dhe një anëtar nga shoqëria civile. Atëherë kërkoj nga ekzekutivin dy emra për komision. Urdhëro drejtoreshë.
Arlinda Raka: Faleminderit shumë. Ë po komisioni do të ketë këtë përbërje nga ekzekutivi po i jap emrat është Besmir Krasniqi dhe Arxhend Guri.

Bashkim Krasniqi: nga PDK propozojmw Shqipe Murseli.

Ernesta Krasniqi: Nga VV Jeton Luma.

Arlinda Raka: Nga Shoqwria Civile Elmihane Malsiu.

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 15 vota per, 3 abstenime, 1 kunder konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM
Vendim për Formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtëshme të komunës

9.Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës.

Arlinda Raka: Komisioni do të ketë këtë përbërje nga ekzekutivi Agron Dema dhe Ardita Shehu. dhe nga Shoqëria Civile ta japim Emrin Dema.

Bashkim Krasniqi: Partia Demokratie propozon Elona Gjinin.

Ernesta Krasniqi: nga Lëvizja Vetëvendosje Buletin Gurin.

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 16 vota per. 4 kundwr dhe asnjw abstenim. konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM

Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtëshme të komunës

10. Kërkesë nga MAPL për shqyrtimin e vendimit 01Nr.104/02-11476/26 për aprovimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kacanikut.

Selajdin Troni: ka ardhë pak më vonë. po besoj që e keni marrë materialin. E keni kërkesë nga MAPL për rishqyrtim. Ja jap fjalwn drejtoreshws pwr sqarime.

Arlinda Raka: pra draft strategjia që është prezantuar me votim në votim ka qenë e rregullt në përmbajtje. Megjithatë MPL ka kërkuar që të gjitha projektet të kenë të përcaktuar koston. Për këtë arsye projektet fillimisht nuk ishin kosto të paraparë pasi realizohen nga stafi i komunës, por janë kostuar tash sipas udhëzimeve të MAPL-së dhe tash kemi marrë edhe një konfirmim nga MAPL-ja se dokumenti është në rregull. Tash ky që po e paraqesim ë pra dhe kërkojmë sërish miratimin dhe procedimin e mëtejmë.

Selajdin Troni: Nwse nuk ka dicka pwr diskutim e hedh pikwn nw votim. Me 11 vota per, 9 kundwr dhe asnjw abstenim. konstatoj se kuvendi komunal mori:

VENDIM

Vendim 01Nr.104/02-11476/26 për aprovimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kacanikut.

Mbledhja i përfundoj në ora 13:30.

Procesmbajtës
Arianita Bajrami

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA